



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:013021
Datë: 13.09.2024
Numri i dokumentit: 06157872

C.nr.332/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Diona Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.B. nga Prizreni me numër personal të cilën me autorizimr përfaqëson B.K. avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren lidhur me çështjen kontestuese shpërblim jubilar, vlerë e kontestit 218.68 euro, jashtë seancës me dt. 12.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.B. nga Prizreni.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite te përvojës se punës ti paguaj 50% te pagës baze e ne shume prej 210.5 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt. 12.01.2024 e deri në pagesën përfundimtare në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- I. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të këtij dispozitivi apo në shumën prej 8.18 euro, si e pa bazuar.
- II. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 € (njëqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. B.K. avokat në Prizren, pranë kësaj gjykate me datën 12.01.2024, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi pagës jubilar, vlera e kontestit 218.68€.

Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune tek SHFMU “Leke Dukagjini” në Prizren, në vendin e punës për me shume se 10 vite. E paditura edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të së drejtave të cilat rrjedhin nga Kontratat Kolektive të Arsimit nr.105 të nënshkruara me dt. 22.01.2021 në mes MASHT dhe SBASHK, është obliguar që punëtorëve të arsimit përkatësisht paditëses S.B. t'ia kompensoj pagën jubilarë për

10 vite përvojë pune, nga paga prej 437.37 euro ne Shumen prej 218.68 euro. Tutje ka theksuar se meqenëse e paditura nuk e ka përmbush obligimin për pagesën e 50 % të shpërblimit jubilar, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sit ë pabazuar, për faktin se pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i pagës jubilarë është në kundërshtim me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga KKA janë vetëm anëtarët e sindikatave të Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtare e kësaj sindikate. Tutje paditësja paraqet padi në gjykatë pa i shterur procedurat administrative sepse nuk është drejtuar fillimisht në Inspektoratin e Punës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse tek e paditura, përkatësisht në Shfmu “ Leke Dukagjini” në Prizren.

Nga vërtetimi me nr. 860/23 të datës 21.06.2023, të nxjerrë nga sekretari i shkollës Shfmu “ Leke Dukagjini” në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja që nga data 01.09.2012 është në marrëdhënie të rregullt pune pranë këtij institucioni arsimor, dhe vazhdon të punoj në këtë institucion arsimor. Ndërsa bazuar në Përgjigjen e dhënë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 11.12.2023, gjykata vërtetoi faktin se paga bazë për mësimdhënësit në Shkollat e Mesme të Ulët është në lartësi prej 421.00 euro.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi ky vërtetim është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, gjykata ua fali besimin e plotë.

Sipas nenit 4 par. 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (LP), në mënyrë decidive përcaktohet se “*Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj*”. Po ashtu, në nenin 90 par. 5 të LP-së, theksohet që “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët*

marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive". Pastaj, në bazë të nenit 78 të LP-së, parashihet e drejta e të punësuarit që të kërkoj nga punëdhënësi për realizim të ndonjë të drejte dhe punëdhënësi është i obliguar që të vendos lidhur me një kërkesë të tillë. Në vazhdim, me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet e drejta e të punësuarit që të kërkoj mbrojtje gjyqësore në Gjykatë Kompetente lidhur me vendimin apo mos veprimin e punëdhënësit lidhur me ndonjë kërkesë së të punësuarit.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Në vazhdim, Në nenin 35 paragrafin 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në shpërblim jubilar, në vitet jubilarë të punësimit nga punëdhënësi i fundit: dhe atë "*për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë; për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë...*".

Në këtë drejtim, kërkesëpadia e paditëses S.B. nga Prizreni, për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të datës 22.01.2021, neni 35, par.8, nën par.8.1, dhe se për paditësen kërkesa është bërë e arritshme ngase e njëjta vitin jubilar të punësimit 10 vite i ka arritur në vitin 2022, pra në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e dt. 22.01.2021 për shkak se kjo kontratë ka qenë e aplikueshme për vitet 22.01.2021 e deri me dt. 21.11.2022, e në rastin konkret paditësja deri me dt. 01.09.2022 tek e paditura ka arritur 10 vite përvojë pune, e që rrjedhimisht vitin jubilar prej 10 viteve paditësja e ka arritur, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të datës 22.01.2021.

Meqenëse paditësja për këtë periudhë ka realizuar pagën bazë prej 421 euro, gjykata vendosi që të detyroj të paditurën që paditëses për 10 vjet të përvojës së punës t'ia paguaj në vlerë të 50% të pagës bazë prej 421 euro, apo në shumë prej 210.5€.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*", andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*", gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditëses të drejtën për shpërblim jubilar në pagën bazë të cilën e realizon paditësja dhe atë në shumën prej 421.00 euro, duke u bazuar në Përgjigjen e dhënë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 11.12.2023, u vërtetua se faktin se paga bazë për mësimdhënësit në Shkollat e Mesme të Ulët është në lartësi prej 421.00 euro , dhe jo siç është kërkuar nga paditësja në shumën prej 437.37 euro, pasi që kjo pagë përfshinë pagën që realizon paditësja bruto. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me

pagën bazë të kërkuar nga paditësja në shumë prej 437.37 euro dhe asaj që paditësja e realizon e që është në shumë prej 421.00 euro, pra shuma e tërësishme e pabazuar është në lartësi prej 8.18 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 12.01.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 134.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.332/2024, datë 12.09.2024

G j y q t a r e

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.